

FSK-ja vazhdon ngritjen e kapaciteteve operacionale me ndihmën e partnerëve



FAÇE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NË DYVJETORIN E VRASJES SË AFRIM BUNJAKUT, KOSOVA KËRKON QË SERBIA T'I DORËZOJË TË AKUZUARIT PËR BANJSKËN

FAÇE 4-5



Të mërkurën janë bërë dy vjet nga rënja heroike e policit tonë, Afrim Bunjaku, i cili ka humbur jetën gjatë sulmit terrorist në Banjskë, duke mbrojtur rendin

dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës. Po në këtë ditë udhëheqësit e Kosovës i kanë kërkuar bashkësisë ndërkombëtare t'i bëjë tryzni

Serbisë për ta dorëzuar të dyshuarin kryesor, Millan Radoiçiqin, edhe të akuzuarit e tjerë për sulmin e armatosur në veri të vendit

KOS: PO PRESIM FORMIMIN E QEVERISË SË RE QË TË ANGAZHOHEMI MË SHUMË ME KOSOVËN PËR DIALOGUN

F. 3



AKREDITOHEN MBI 18 MIJË VËZHgues PËR ZGJEDHJET LOCALE

F. 7



EKSPORTET E KOSOVËS NË VENDET E BE-SË ARRITËN NË 23,4 MILIONË EURO

F. 8

GËRXLHIU: ROLI I KOMUNAVE NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM EKONOMIK ËSHTË FUQIA QË SHPESH NËNVLERËSOHET

F. 8

SPORT



LIRIA NDAHET ME KLODIAN DURON

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

MACRONI THOTË SE TRUMPI DUHET TA NDALË LUFTËN NË GAZË NËSE DËSHIRON TA FITOJË NOBELIN PËR PAQE

PARIS, 24 SHTATOR - Nëse presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, dëshiron vërtet ta fitojë çmimin Nobel për paqe, atëherë ai duhet ta ndalë luftën në Rripin e Gazës, tha të martën mbrëma presidenti i Francës, Emmanuel Macron. Duke folur për televizionin francez BFM TV nga Nju-Jorku, Macroni tha se vetëm Trumpi e ka fuqinë për të ushtruar tryzni ndaj Izraelit për t'i dhënë fund luftës. “Nëse ka dikush që mund të bëjë diçka për këtë, atëherë ai është presidenti i ShBA-së”, tha Macroni. “Dhe arsyeja pse ai mund të bëjë më shumë se ne, është sepse ne nuk furnizojmë me armë që bëjnë të mundur zhvillimin e luftës në Gazë. Ne nuk

furnizojmë me pajisje që e bëjnë të mundur luftën në Gazë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës po”, shtoi ai. Trumpi mbajti një fjalim të gjatë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së të martën, ku i hodhi poshtë përpjekjet e aleatëve perëndimorë për ta mbështetur krijimin e një shteti palestinez, duke thënë se një gjë e tillë do të ishte shpërblim për militantët e Hamasit. Hamasi është grup palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian. “Ne duhet ta ndalim menjëherë luftën në Gazë. Duhet të zhvillojmë bisedime për paqe pa vonesa”, tha Trumpi. Duke folur për fjalimin e Trumpit, Macroni tha: “Shoh një



president amerikan të angazhuar, që përsëriti këtë mëngjes në podium: ‘Unë dua

paqe. Kam zgjidhur shtatë konflikte’. Një president që dëshiron çmimin Nobel për

paqe. Ky çmim është i mundur vetëm nëse e ndal këtë konflikt”. Vende si Kamboxhia, Izraeli dhe Pakistani janë në mesin e atyre që e kanë nominuar Trumpin për këtë çmim vjetor për shkak të marrëveshjeve për paqes ose armëpushimeve që ka ndërmjetësuar. Trumpi ka thënë se e meriton këtë çmim, të cilin e kanë fituar katër paraardhës të tij në Shtëpinë e Bardhë. “Presidenti Trump ka bërë më shumë për paqen se të gjithë të pranishmit në Kombet e Bashkuara së bashku”, tha zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Anna Kelly. “Vetëm ky president ka mundur të arrijë kaq shumë për stabilitetin global, sepse ai në mënyrë efektive e ka bërë Amerikën sërish të fortë”.

AVIONI I MINISTRES SPANJOLLE PËRBALLET ME NDËRPRERJE TË GPS-së AFËR KALININGRADIT TË RUSISË

MADRID, 24 SHTATOR - Një avion ushtarak spanjoll, i cili po bartte ministren e Mbrojtjes, Margarita Robles, u përball me “ndërprerje” të sinjaleve të GPS-së të mërkurën në mëngjes, derisa po fluturonte pranë Kaliningradit të Rusisë, rrugës për në Lituani, njoftoi Ministria spanjolle. Ajo nuk dha më shumë hollësi rreth rastit. Përveç Roblesit, avioni po bartte edhe të afërm të ushtarëve spanjollë që janë pjesë e misionit të ri të mbrojtjes ajrore të NATO-s në krahun lindor, i cili filloi në fillim të këtij muaji pasi Polonia rrëzoi dronë që kishin shkelur hapësirën e saj ajrore. Kontingjenti spanjoll, i njohur



si misioni Vilkas, që do të thotë “ujk” në gjuhën lituaneze, javën e kaluar interceptoi tetë avionë

rusë që vepronin mbi Detin Baltik, tha Ministria e Mbrojtjes e Spanjës në një deklaratë të

mërkurën. Robles pritet ta zhvillojë një takim dypalësh me homologen lituaneze Dobile Sakaliene gjatë vizitës në bazën ajrore të Siauliai mëngjesin e së mërkurës, sipas agjendës së Qeverisë spanjolle. Ky incident e pason atë me presidentin e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, GPS-të e avionit të së cilës u ndërpre gjatë udhëtimit për në Bullgari më 31 gusht. Një zëdhënës i BE-së tha se autoritetet bullgare dyshonin se incidenti ishte shkaktuar nga ndërhyrja e Rusisë. Estonia dhe Finlanda, gjithashtu, më parë kanë fajësuar Rusinë për ndërprerjen e pajisjeve të navigimit, GPS, në


hapësirën ajrore të rajonit. Rusia ka mohuar ndërhyrjen në komunikime dhe rrjete satelitore. Shumica e aeroplanëve modernë kanë një sërë sensorësh dhe burimesh për ta përcaktuar pozicionin, përveç GPS-së, që do të thotë se ata mund të fluturojnë edhe në rast se u bllokohen GPS-të. Një komandant në bord të avionit spanjoll u tha gazetarëve që udhëtonin me Robles, se incidente të tilla janë të zakonshme kur fluturohet pranë Kaliningradit, si për avionët civilë, po ashtu edhe për ata ushtarakë, dhe avioni spanjoll mund të navigojë gjithashtu duke përdorur satelitë ushtarakë.

NASA NIS MISIONIN PËR STUDIMIN E MOTIT HAPËSINOR

UASHINGTON, 24 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara kanë nisur në hapësirë tri anije kozmike në përpjekje që të monitorojë më mirë motin hapësinor, sikurse janë stuhitë diellore të cilat mund të ndërhyjnë në teknologjinë dhe sistemet energjetike në Tokë. Tri sondat u lëshuan nga Qendra Hapësinore Kennedy në Florida në një raketë Falcon 9, të ndërtuar nga kompania private SpaceX. Me të arritur në hapësirë, sondat do ta nisin rrugëtimin e gjatë për të arritur në pikën Lagrange 1 - një pikë që përafërsisht është 1.5 milion kilometra nga Dielli, vend që ofron një pikë të qëndrueshme

për vërtetim. Sonda për shenjëzimin ndëryjor dhe përshpejtim (IMAP) do t'i përdorë instrumentet e tij për të studiuar grimcat me energji të lartë të Diellit dhe fluskën mbrojtëse që gjendet përreth sistemit tonë diellor të njohur si heliosferë, të dhëna të cilat mund të ofrojnë njohuri për motin hapësinor dhe rrezatimin kozmik. Stuhitë diellore janë ngjarje me nivel të lartë të rrezatimit që shkaktohen nga shkëndijat në sipërfaqen e Diellit. Këto stuhi është shumë vështirë të parashikohen. Stuhitë diellore mund të kenë ndikim në aktivitetet në Tokë,

përfshirë në aviacion, në komunikimet mobile dhe në rrjetet elektrike - dhe potencialisht mund të vënë në rrezik astronautët dhe satelitët në hapësirë. Anija kozmike për monitorimin e motit hapësinor SWFO-L1, që operohet nga Administrata Kombëtare Oqeanike dhe Atmosferike e ShBA-së (NOAA), synon të detektojë paraprakisht ngjarje të motit. “Kjo mund të parandalojë një kërcënim që po vjen, mund të na japë kohë që të përgatitemi”, tha Irene Parker nga NOAA. Me informatën paraprake për stuhi të mundshme, autoritetet mund t'i strehojnë astronautët, t'i paralajmërojnë pilotët e



avionëve për mundësinë e ndërprerjeve të sistemeve të GPS-së dhe t'i përgatisin rrjetet elektrike për pengesa të mundshme. Ndërkaq Vëzhguesi Carruthers

Geocorona, që do të jetë pasagjeri i tretë në raketën Falcon 9, do ta studiojë ekzosferën e Tokës në përpjekje për të kuptuar se si moti hapësinor ndikon në të.

Kosova dhe Kroacia angazhohen për zhvillim dhe investime për qytetarët

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Zëvendëskryeministrja dhe ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, zhvilloi një takim me ministrin e Jashtëm të Kroacisë, Gordan Grlic Radman, në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork. Ministrja Gërvalla dhe ministri Radman diskutuan për hapat konkretë për thellimin e bashkëpunimit dypalësh, duke përfshirë finalizimin e marrëveshjeve në proces, nga

njohja e ndërsjellë e patentëshoferëve deri te bashkëpunimi në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes civile.

Palët u pajtuan mbi rëndësinë e nxitjes së investimeve dhe krijimit të një Komisioni të Përbashkët për Tregti dhe Ekonomi, në mënyrë që miqësia ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë të reflektohet drejtpërdrejt në zhvillim konkret për qytetarët.

Me theks të veçantë u diskutua edhe përfshirja e të rinjve në proceset shoqërore

dhe demokratike. “Forcimi i demokracisë kalon përmes përfshirjes së të rinjve. Kosova dhe Kroacia janë të vendosura t’i japin brezit të ri hapësirën që meriton, sepse nga ta varet e ardhmja e shoqërive tona”, tha ministrja Gërvalla.

Në mbyllje të takimit, ministrja Gërvalla u shpreh se Kosova mbetet përherë mirënjohëse për mbështetjen e vazhdueshme të Kroacisë në të gjitha fazat e shtetndërtimit, duke e konsideruar Kroacinë shtet mik dhe partner i çmuar.



KOS: PO PRESIM FORMIMIN E QEVERISË SË RE QË TË ANGAZHOHEMI MË SHUMË ME KOSOVËN PËR DIALOGUN

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Komisionarja për Zgjerim e Bashkimit Evropian, Marta Kos, tha se Brukseli po pret formimin e një qeverie të re në Prishtinë në mënyrë që të angazhohet më shumë me Kosovën sa i përket dialogut për normalizim të raporteve me Serbinë.

Në një intervistë për Shërbimin e Ballkanit të “Radios Evropa e Lirë”, Kos përsëriti qëndrimin e bllokut evropian se normalizimi i raporteve është kusht për Kosovën dhe Serbinë në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. “Dhe ne po punojmë për këtë, në veçanti edhe me përfaqësuesen tonë të lartë, Kaja Kallas. Ne jemi vazhdimisht të angazhuar me Serbinë për këtë çështje, ndërsa me Kosovën më pak muajt e fundit, sepse jemi ende në pritje të formimit të një qeverie të re. Por, kjo mbetet një nga prioritetet në gjithë procesin e gjashtëshes së Ballkanit Perëndimor”, tha Kos në intervistën dhënë në Sarajevë.

Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog nën ndërmjetësimin e Brukselit që nga viti 2011. Procesi fillimisht nisi në nivel teknik dhe më pas palët u angazhuan edhe në dialog në nivelin politik.

Gjatë procesit palët kanë arritur një sërë marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar në terren. Që nga zgjedhjet e mbajtura në shkurt, Kosova ende nuk ka formuar një ekzekutiv të ri. Edhe gjatë kësaj periudhe,



kur Kosova po udhëhiqet nga një qeveri në detyrë, në Bruksel janë mbajtur raunde bisedimesh në nivel të kryenegociatorëve. I fundit u mbajt më 11 shtator - takim që nuk prodhoi asnjë rezultat.

Për dallim nga takimet mes kryenegociatorëve, Kosova dhe Serbia nuk kanë zhvilluar dialog në nivel politik që nga shtatori i vitit 2023. Raundi i fundit i dialogut politik u zhvillua vetëm disa ditë para sulmit të armatosur në Banjskë të Zveçanit, kur u vra

një polic i Kosovës.

Kosova fajëson Serbinë për sulmin, por Beogradi mohon se ka gisht në të.

Përfaqësuesja e lartë e BE-së, Kaja Kallas, pasi mori detyrën në krye të diplomacisë evropiane në fillim të këtij viti, i tha “Radios Evropa e Lirë” se procesi i dialogut ka ngecur dhe se BE-ja po shqyrton mjete të tjera për normalizim.

Më pas ajo deklaroi se Brukseli është duke i analizuar gabimet e bëra në këtë proces.

Zyrtarja e lartë evropiane,

Marta Kos, po qëndron në Bosnjë-Hercegovinë, në një vizitë treditore, ku është takuar me përfaqësues të institucioneve të Bosnjë-Hercegovinës, organizatave joqeveritare dhe me të rinj. Gjatë intervistës për “REL”-in, Kos foli edhe për situatën në entitetin e Republikës Sërpska në Bosnjë-Hercegovinë, pasi paraprakisht tha se nuk ka arsye pse të takohet me Millorad Dodikun, të cilit i është marrë mandati i presidentit të entitetit nga autoritetet zgjedhore të

Bosnjës. Megjithatë, ai ende paraqitet si udhëheqës i Republikës Sërpska. “Na duhet Republika Sërpska në mënyrë që të mund të ecim përpara me të gjithë Bosnjë-Hercegovinën. Kjo ka qenë e mundur në të kaluarën dhe besoj se do të jetë e mundur edhe në të ardhmen”, tha Kos, duke shtuar se Republika Sërpska është më shumë sesa politikanët e saj dhe se popullata meriton një të ardhme më të mirë.

Ajo, po ashtu, tha se anëtarësimi i Bosnjë-Hercegovinës në Bashkimin Evropian është një domosdoshmëri, por kjo mbetet në duart e liderëve politikë të vendit.

Kos tha se procesi i zgjerimit nuk mund të ecë përpara pa hapa konkretë nga autoritetet vendore. “Bashkimi Evropian nuk është një organizatë bamirëse. Këto janë para të taksapaguesve, para të qytetarëve tanë. Duhet të jemi të përgjegjshëm. Kërkohet përkushtim që udhëheqja e Bosnjë-Hercegovinës t’i zbatojë ato reforma që do të sjellin përfitime për qytetarët tuaj”, tha Kos.

Komisionarja përsëriti se BE-ja respekton integritetin territorial dhe rendin kushtetues të Bosnjë-Hercegovinës, duke paralajmëruar se vendi duhet të bëhet mjaftueshëm i fortë për të funksionuar pa mbikëqyrje ndërkombëtare. “Vetëm atëherë Bosnjë-Hercegovina do të mund të bëhet anëtare e BE-së”, tha ajo.

Begaj takon Macronin, e quan mik të mirë të Shqipërisë

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka takuar presidentin e Francës, Emmanuel Macron, të cilin e ka quajtur mik të mirë

të Shqipërisë.

Takimi në mes të Begajt dhe Macornit ka ndodhur në kuadër të Marrëveshjes së BBNj-së. “Është kënaqësi të

takohem me presidentin e Francës, Emmanuel Macron, një mik i mirë i Shqipërisë. Këtë herë takimi ynë ishte në kuadër të Marrëveshjes së

BBNJ-së. Shqipëria i është bashkuar kësaj nisme, duke bërë të mundur hyrjen në fuqi të saj”, ka shkruar ai në “Facebook”.





NË DYVJETORIN E VRASJES SË AFRIM BUNJAKUT, KOSOVA KËRKON QË SERBIA T'I DORËZOJË TË AKUZUARIT PËR BANJSKËN

Të mërkurën janë bërë dy vjet nga rënia heroike e policit tonë, Afrim Bunjaku, i cili ka humbur jetën gjatë sulmit terrorist në Banjskë, duke mbrojtur rendin dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës. Po në këtë ditë udhëheqësit e Kosovës i kanë kërkuar bashkësisë ndërkombëtare t'i bëjë trysni Serbisë për ta dorëzuar të dyshuarin kryesor, Millan Radoiçiqin, edhe të akuzuarit e tjerë për sulmin e armatosur në veri të vendit

Kurti. Ai u bëri thirrje faktorëve ndërkombëtarë, që të mos e konsiderojnë Serbinë shtet normal përderisa ajo nuk i dorëzon kriminelët e Serbisë, të organizuar dhe udhëhequr nga Millan Radoiçiqi dhe të financuar e të mbështetur nga Beogradi zyrtar dhe presidenti atje, Aleksandër Vuçiq. "Aktakuza i përfshinë 45 persona. Këta duhet të dorëzohen menjëherë shtetit të Kosovës, ku ka aktakuzë për ta dhe pa numër fakte e argumente për përfshirjen e tyre në këtë vrasje të Afrim Bunjakut

dhe në këtë sulm agresor e terrorist të tyre. Në të njëjtën kohë, duhet ta theksojmë edhe faktin tjetër, që kjo është një betejë e fituar nga Policia e Kosovës për Republikën e Kosovës dhe gjithë qytetarët pa dallim", tha Kurti. Ndërkaq, ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, tha se një ditë si kjo para dy vitesh, që filloi si jashtëzakonisht e rëndë, por edhe e dhimbshme, përfundoi ndër më krenaret në historinë e Republikës së Kosovës. "Lavdi Afrim Bunjakut! Lavdi të gjithë dëshmorëve të Republikës së

Kosovës, e mirënjohje pafund për të gjithë ata që sollën që kjo ditë me të vërtetë të mbetet ditë e shënuar ku integriteti dhe sovraniteti i Republikës së Kosovës veçse u forcuan", tha ministri Sveçla. Serbia e ka mohuar çdo përfshirje në sulmin e Banjskës dhe ende nuk ka ngritur aktakuzë ndaj tij, pavarësisht se vitin e kaluar kishte paralajmëruar se do ta bënte. Gjykata e Lartë në Beograd tha për "Radion Evropa e Lirë" këtë javë se Radoiçiqit i është zgjatur masa e ndalimit të largimit nga Serbia, me detyrimin që të

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Udhëheqësit e Kosovës i kanë kërkuar bashkësisë ndërkombëtare t'i bëjë trysni Serbisë për ta dorëzuar të dyshuarin kryesor Millan Radoiçiq dhe të akuzuarit e tjerë për sulmin e armatosur në veri të vendit, në dyvjetorin e vrasjes së rreshterit policor Afrim Bunjaku. Bunjaku u vra më 24 shtator 2023 gjatë një sulmi që një grup serbësh të armatosur e kryen kundër Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë të Zveçanit. Dy vjet pas sulmit, njeriu që e mori përgjegjësinë për organizimin e tij, Millan Radoiçiq, është ende i lirë dhe me vendbanim të regjistruar në Beograd. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, i shoqëruar nga kryetari i Kuvendit, Dimal Basha, ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, drejtues të institucioneve të sigurisë e deputetë të Kuvendit, vizitoi familjen Bunjaku, për të

vazhduar pastaj bashkë me zëvendëskryeministrin në detyrë, Besnik Bislimi, anëtarë të tjerë të kabinetit qeveritar, deputetë të Kuvendit dhe me familjarë të heroit të Kosovës, Afrim Bunjaku, për homazhe te varri tij, në dyvjetorin e rënies në Basnjë të Zveçanit. Duke kujtuar rënien heroike të rreshterit Afrim Bunjaku, kryeministri Kurti tha se ishte një rënie, e cila e ngriti Republikën e Kosovës, shtetin tonë të pavarur edhe së brendshmi, por edhe në reputacionin e saj ndërkombëtar, sepse kemi të bëjmë me një shtet i cili i del zot vetvetes dhe i cili ka policë që sakrifikohen për t'i mbrojtur qytetarët pa dallim, duke e mirëmbajtur rendin publik dhe sundimin e ligjit. "Tash, të gjithë ne bashkë, jemi pjesë e familjes Bunjaku, të bashkëshortes Lumnije, të fëmijëve, Arbenitës, Jetlunit e Fatlunit, sepse Afrim Bunjaku i përket Republikës së Kosovës dhe gjithë popullit, që do ta mbajë për jetë e mot në zemrat e veta këtë hero të Kosovës", u shpreh kryeministri



AKREDITOHEN MBI 18 MIJË VËZHGUER PËR ZGJEDHJET LOKALE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbajti mbledhjen e 58, të kryesuar nga kryesuesi Kreshnik Radoniqi. Në këtë mbledhje u paraqit raporti për dërgimin e pakove me fletëvotime për votuesit e regjistruar jashtë Kosovës, për votim me postë për zgjedhjet lokale.

Sipas raportit, KQZ-ja ka nisur përmes postës rreth 44 000 pako me fletëvotime për votuesit e regjistruar në disa shtete dhe shërbimet postare po i përcjellin te votuesit e regjistruar në adresat e dhëna prej tyre gjatë procesit të regjistrimit.

Nga ky numër i përgjithshëm, rreth 41 879 pako janë dorëzuar në bashkëpunim me Postën e Kosovës dhe 2 050 të tjera përmes

postës së shpejtë.

Zarfi i cili i dërgohet votuesit përmban: fletëvotimet; zarfin e fshehtësisë; udhëzuesin me informacione se si plotësohen fletëvotimet dhe si realizohet votimi përmes postës; zarfin kthyes dhe shiritin mbyllës.

Në votimin jashtë Kosovës për votim me postë në zgjedhjet lokale, detyrë e votuesit është që pakon me fletëvotime ta dërgojë në ndonjërin nga kutitë postare të KQZ-së.

Në shumicën e këtyre zarfeve KQZ-ja ka shënuar paraprakisht adresën e kutisë postare në shtetin përkatës të votuesit të regjistruar. Në rastet kur adresa nuk është shënuar nga KQZ-ja, votuesi duhet ta shënojë njërin nga adresat e kutive postare të KQZ-së.

Periudha e votimit përmes postës, e cila ka filluar më 17 shtator dhe do të përfundojë më 11 tetor 2025,



vlen vetëm për 43 933 shtetasit që janë regjistruar suksesshëm si votues jashtë Kosovës.

Po në këtë mbledhje, KQZ-ja mori vendim për akreditimin e 18 041 vëzhguesve të 51 subjekteve

politike të certifikuara për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale 2025.



paraqitet në polici më 1 dhe 15 të çdo muaji.

Vitin e kaluar Kosova ngriti aktakuzë kundër 45 të dyshuarve për sulmin në Banjskë, ndërsa vetëm tre nga këta të akuzuar janë duke u gjykuar në Prishtinë, pasi të tjerët janë të paarritshëm për autoritetet e Kosovës. Që tre të mohojnë akuzat. “Të akuzuarit duhet t’i dorëzohen menjëherë Kosovës, ku ka aktakuzë për ta dhe fakte të panumërta për përfshirje në këtë vrasje të Afrim Bunjakut dhe në këtë sulm agresor e terrorist të tyre”, tha Kurti.

Kurti shtoi se “rënia heroike e Afrim Bunjakut nuk ishte e kotë, ishte një rënie që e ngriti Republikën e Kosovës brenda dhe në reputacionin e saj ndërkombëtar [duke treguar] që kemi të bëjmë me një shtet i cili i del zot vetvetes dhe i cili ka policë për t’i mbrojtur qytetarët pa dallim”.

Ndërkohë, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, tha se Serbia duhet t’i dorëzojë “terroristët për të cilët ka aktakuzë dhe i bëjmë thirrje edhe bashkësisë ndërkombëtare të ushtrojë

trysni ndaj Serbisë”.

Kosova i ka kërkuar vazhdimisht bashkësisë ndërkombëtare të bëjë trysni mbi Serbinë, por Beogradi nuk pranon t’i ekstradojë të akuzuarit, duke thënë se ata do të gjykohen në Serbi.

Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë tha se është e “papranueshme” që dy vjet nga sulmi, Radoiçiqi vazhdon të jetojë i lirë në Serbi. “Dy vjet pas vrasjes së oficerit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, dhe pavarësisht prej premtimeve të shumta se kryerësit do të përgjigjen para ligjit, ende nuk është dhënë drejtësi. Është e

domosdoshme që llogaridhënia dhe drejtësia të zbatohen pa asnjë vonesë tjetër”, tha Ambasada e Gjermanisë.

Ambasada e Britanisë në Prishtinë u bëri thirrje autoriteteve serbe t’i arrestojnë dhe t’i sjellin para drejtësisë Radoiçiqin dhe të akuzuarit e tjerë. Gjithashtu, ajo shprehu nderimet e saj për “profesionalizmin dhe trimërinë” e Policisë së Kosovës për veprimet e saj për të vendosur rregull më 24 shtator 2023 dhe prokurorët e Kosovës për “punën e durueshme” për ta zhvilluar aktakuzën për Banjskën.



Në dyvjetorin e rënies përkujtohet heroi Afrim Bunjaku

Në dyvjetorin e rënies heroike të policit Afrim Bunjaku, kryetari i Vushtrrisë, Ferit Idriz, së bashku me bashkëpunëtorë, ka bërë homazhe pranë varrit të tij dhe ka vizituar familjen Bunjaku, duke përcjellë mirënjohjen dhe respektin e qytetit për sakrificën supreme që ai bëri. “24 shtatori do të mbetet përgjithmonë në kujtesën tonë si ditë e dhimbjes dhe krenarisë. Afrimi ishte baba e qytetar i ndershëm i Vushtrrisë tonë, që u përball me guxim ndaj një sulmi të organizuar ushtarakisht e të financuar nga Serbia. Rënia e tij nuk është vetëm humbje për familjen, por plagë e përbashkët për gjithë Kosovën. Heroi ynë do të mbetet përjetësisht shembull i trimërisë dhe përkushtimit ndaj atdheut. Lavdi e përjetshme Afrim Bunjakut!”, ka shkruar Idrizi në “Facebook”.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se afrimi mbetet testament i guximit dhe përkushtimit për mbrojtjen e Republikës së Kosovës. “Sakrificat e tij është e gdhendur në historinë tonë kombëtare dhe do të kujtohet

përherë si shembull i nderit dhe i besës ndaj atdheut. Por, dy vite pas këtij akti terrorist, drejtësia ende nuk është vendosur. Kriminelët e strehuar e të mbajtur të paprekur në Serbi duhet të dorëzohen dhe të përgjigjen përpara ligjit, sepse vetëm kështu nderohet sakrificat e Afrimit dhe sigurohet e ardhmja e Kosovës”, ka thënë Krasniqi.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se Afrim Bunjaku nuk ishte vetëm një polic në krye të detyrës. “Ishte një njeri me vlera të mëdha, që zgjodhi të qëndrojë deri në fund për parimet e lirisë, drejtësisë dhe rendit demokratik. Sakrificat e tij mbetet një kujtesë e gjallë për sfidat me të cilat përballet Kosova, por edhe për vendosmërinë tonë për të mos u dorëzuar përballë dhunës dhe përpjekjeve për destabilizim. Përgjegjësia për këtë akt kriminal i takon jo vetëm autorëve të drejtpërdrejtë, por edhe atyre që e ideuan dhe e nxitën, e të cilët duhet të mbahen përgjegjës para drejtësisë”, ka thënë Abdixhiku.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se në përvjetorin e rënies së Afrim Bunjakut, shpreh respektin e përjetshëm për sakrificën e tij, që është një nder i përhershëm për Kosovën dhe të gjithë qytetarët e saj.

Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi në mes të Policisë së Kosovës dhe Kolegjit UBT

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Policia e Kosovës, me qëllim të ngritjes së mëtejme dhe zhvillimit të kapaciteteve dhe burimeve njerëzore në fushën e teknologjisë informative dhe komunikimit, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me një nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, respektivisht me Kolegjin UBT.

Në këtë takim drejtori i përgjithshëm i PK-së, kolonel

Gazmend Hoxha, me bashkëpunëtorë, priti në një takim përfaqësuesin e institucionit të lartcekur ku, përveç marrëveshjes së nënshkruar, u diskutua edhe për vendosjen e formave të reja të bashkëpunimit reciprok, me qëllim të krijimit të mundësive të reja për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, arsimimin, trajnimin profesional,

shkëmbimin e përvojave akademike dhe praktike në mes të palëve, si dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta në sektorin e sigurisë publike dhe arsimit të lartë.

Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar që në vazhdimësi të ndërmarrë hapa për mbështetjen e pjesëtarëve të PK-së në fushën e ngritjes së nivelit profesional dhe avancimit të mëtejme të tyre.



MUNGESA E KONTROLLEVE FUNKSIONALE DHE TEKNIKE NË APLIKACIONET E PLATFORMËS E-KOSOVA RREZIKON SAKTËSINË E TË DHËNAVE

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka realizuar auditimin e Teknologjisë së Informacionit “Platforma e shërbimeve online e-Kosova” për periudhën 2024 - qershor 2025 i cili ka vlerësuar nëse kjo platformë u mundëson qytetarëve shërbime elektronike efikase, të sakta, të sigurta dhe të besueshme. Fokusi i auditimit ka qenë në shërbimet “Shtesat për fëmijë”, “Tatimi në pronë”, “Subvencionimi i librave” dhe moduli “Pagesat elektronike”. Ndonëse “Platforma e-Kosova”

ka kontribuar në digjitalizimin, transparencën dhe efikasitetin e proceseve administrative, ajo vazhdon të përballët me mangësi në kontrollet e aplikacionit, të cilat ndikojnë në integritetin, saktësinë dhe sigurinë e të dhënave. Rezultatet e auditimit tregojnë se për shërbimet “Subvencionimi i librave” dhe “Shtesat për fëmijë”, mungesa e ndërlidhjes së duhur të sistemeve ka lejuar përfitimin e subvencionit të librave pa plotësuar kushtet e nevojshme dhe për shtesat e fëmijëve aplikime të dyfishta. Mungesa e përditësimit të gjendjes së



pagesës në kohë reale dhe kontrollet e dobëta në modulën e pagesave kanë lejuar pagesa

të njëjta të ekzekutohen disa herë, duke shkaktuar dëme financiare për qytetarët. Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, e cila menaxhon platformën e-Kosova, nuk ka vendosur standarde të mjaftueshme për menaxhimin e kontratave, duke lënë paqartësi mbi përgjegjësitë për sigurinë e informacionit, nuk garanton mjedis të sigurt informacioni për shkak të politikave të vjetruara dhe mungesës së tyre, si dhe nuk është e përgatitur për t'i rikthyer shërbimet në raste emergjente ose fatkeqësie duke rrezikuar vazhdimësinë e

operacioneve shtetërore elektronike. Lidhur me këtë auditim, auditorja e përgjithshme Vlora Spanca tha se platforma e-Kosova ka shënuar përparim të dukshëm në digjitalizimin e shërbimeve publike, megjithatë ka ende sfida në integrimin e sistemeve, sigurinë e informacionit, kontrollin dhe besueshmërinë e të dhënave si dhe në vazhdimësinë e biznesit. Me qëllim të përmirësimit të kontrolleve, integritetit, digjitalizimit dhe sigurisë së platformës e-Kosova, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 15 rekomandime.

61 HULUMTIME DHE PUNIME SHKENCORE U PARAQITËN NË KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE TË INSTITUTIT PEDAGOGJIK TË KOSOVËS



PRISHTINË, 24 SHTATOR - Pas një angazhimi disamujor, Instituti Pedagogjik i Kosovës me shumë sukses e përmbylli konferencën vjetore. Ishte një konferencë në të cilën u paraqitën 61 hulumtime dhe punime shkencore. Konferenca zgjati dy ditë dhe ishte e organizuar në dy seanca plenare. Pjesa tjetër e konferencës ishte e ndarë në gjashtë sesione shkencore paralele, si dhe në një punëtori që i kushtohej arsimit të të rriturve. Në konferencë

kishte referues nga Estonia, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe nga shtetet e tjera. Bazuar në pjesëmarrjen, përgatitjet dhe zhvillimin me sukses të saj, kjo konferencë, për nga pjesëmarrja, tematikat dhe prurjet shkencore, ishte ndër më të mëdhatë dhe më të suksesshmet në Kosovë. Pjesëmarrja dhe angazhimi i hulumtuesve dhe shkencëtarëve të fushës së edukimit, nga të gjitha vendet e rajonit dhe nga Kosova, ishte tregues i rritjes së vazhdueshme të Institutit

Pedagogjik dhe i punës serioze shkencore dhe profesionale që bëhet gjithnjë dhe çdoherë në institucionin tonë. Konferenca ishte e tillë falë angazhimit të koordinatorëve, Këshillit Organizativ dhe Këshillit Shkencor. Falënderojmë pjesëmarrësit, prezantuesit, hulumtuesit dhe të gjithë ata që dhanë kontributin e tyre për mirëvajtjen e konferencës, e cila, që nga ky vit, do të bëhet pikë reference për hulumtuesit vendorë dhe ndërkombëtarë.

Shikohen mundësitë e bashkëpunimit të UP-së me Universitetin Ondokuz Mayis të Turqisë

Prishtinë, 24 shtator - Një delegacion i lartë nga Universiteti Ondokuz Mayis i Samsunit të Turqisë ka vizituar Rektoratin e Universitetit të Prishtinës. Rektorja prof. Fatma Aydin, koordinatori për bashkëpunime ndërkombëtare prof. Ahmet Aycan dhe prof. İlkey Erken nga Fakulteti i Shkencave Humane e Shoqërore, u pritën nga rektori prof. Arben Hajrullahu dhe prorektorja për ndërkomb-

ëtarizim, prof. Rozafa Basha. Në takim morën pjesë edhe përfaqësues të Shoqatës “Esnaf” nga Prizreni. U diskutua për projekte të përbashkëta në fushën e mjekësisë dhe kirurgjisë si dhe për mundësi bashkëpunimi në teknologji informative e inxhinieri. Palët u pajtuan që të identifikohen fushat me interes të dyanshëm, me synim nënshkrimin e marrëveshjeve në shërbim të studentëve dhe

stafit akademik. Universiteti Ondokuz Mayis, i themeluar në vitin 1975, radhitet ndër 1200-1500 universitetet më të mira në botë sipas “QS World University Rankings” dhe ofron programe në mjekësi, bujqësi, drejtësi, inxhinieri, ekonomi, edukim, turizëm, arte dhe shkencë humane. Aktualisht, gjashtë studentë nga Kosova vijnë studimet në Fakultetin e Edukimit të këtij universiteti.



FSK-ja vazhdon ngritjen e kapaciteteve operacionale me ndihmën e partnerëve

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), me mbështetjen e Organizatës për Menaxhimin e Trajnimeve dhe Asistencës së Sigurisë të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SATMO), vijon përpjekjet për avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve operacionale dhe mbështetjes luftarake të personelit ushtarak. Në përputhje me planet e trajnimit dhe në bashkëpunim të ngushtë me SATMO, si dhe me Forcat e Armatosura të

Republikës së Shqipërisë, po realizohet aktiviteti i gjuajtjes taktike me mortaja në stërvitjen që po zhvillohet në Biza të Republikës së Shqipërisë. Ky aktivitet synon rritjen e gatishmërisë operative, forcimin e bashkëpunimit rajonal në mes të forcave tona dhe partnerëve ndërkombëtarë. Trajnimi është realizuar në pjesën teorike dhe praktike, i fokusuar në tri detyra kryesore: Trajnimi me mortaja (Mortar training), Kursi për udhëheqës

të këmbësorisë dhe Mortajave (Infantry mortar leader course), Vëzhgues i përparmë (Forward observer) ku janë stërvitur në: Përdorimin e sigurt të mortajave, shënjestrimi, gjuajtja, stërvitje e procedurave të koordinimit dhe komunikimit midis elementeve të zjarrit dhe njërive taktike, shkëmbim të përvojave dhe praktikave më të mira me trajnerët dhe këshilltarët e partnerëve ndërkombëtarë etj. Ky bashkëpunim forcon kapacitetet profesionale të FSK-



së dhe kontribuon në sigurinë dhe stabilitetin rajonal përmes trajnimit të sinkronizuar dhe

bashkëpunimit të vazhdueshëm me partnerët tanë.

AMBASADORI BRITANIK: UDHËHEQËSIT POLITIKË T'I RESPEKTOJNË VENDIMET E KUSHTETUESES

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves, tha se pret që vendimet e Gjykatës Kushtetuese sa i përket konstituimit të Kuvendit të Kosovës të respektohen dhe zbatohen nga udhëheqësit politikë. Këto deklarata ai i bëri pasi u takua me kreun e Gjykatës Kushtetuese, Nexhmi Rexhepi. Kushtetuesja ka vendosur masë të përkohshme nga 5 shtatori deri më 30 shtator, duke ua ndaluar deputetëve të ndërmarrin veprime dhe duke ndaluar zhvillimin e ndonjë procedure për formimin e Qeverisë së re të Kosovës. Gjykata më e lartë në Kosovë është duke e trajtuar kërkesën e dorëzuar nga Lista Serbe - partia kryesore e serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit - lidhur me çështjen e zgjedhjes së nënkryetarëve të Kuvendit nga radhët e komuniteteve joshumicë. "Mbretëria e Bashkuar pret që vendimet e Gjykatës Kushtetuese që lidhen me formimin e Kuvendit të respektohen dhe zbatohen nga udhëheqësit politikë në mënyrë që t'i jepet fund ngërçit në të cilin është futur Kosova që një kohë të gjatë dhe në mënyrë që Kuvendi dhe Qeveria e re të mund të nisin punën në interes të popullit të



Kosovës. Puna e Gjykatës është vitale në mbrojtjen e Kushtetutës së Kosovës. Pavarësia është thelbësore për punën e Gjykatës", tha ambasadori Hargreaves përmes një postimi në "Facebook". Lëvizja Vetëvendosje e Albin

Kurtit, por edhe grupi i deputetëve të pakicave joserbe, kanë dorëzuar komente në Kushtetuese, duke kërkuar nga gjykata më e lartë në Kosovë që të shpallë të papranueshme çështjen e Listës Serbe. Pas vendosjes së masës së

përkohshme, kryeministri në detyrë, Albin Kurti dhe zyrtarë të LV-së, përfshirë nënkryetarin Glauk Konjufca, e kanë kritikuar Kushtetuesen për njëanshmëri, duke thënë se ajo është e afërt me partitë shqiptare që mandatin e kaluar ishin në opozitë.

Bashkimi Evropian ka bërë thirrje për mosndërrhyrje në punën e Kushtetueses, ndërkajq Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë, po ashtu, u bëri thirrje aktorëve politikë dhe institucioneve ta respektojnë Gjykatën Kushtetuese dhe të përmbahen nga sulmet ndaj saj. Lista Serbe beson se janë kryer shkelje kushtetuese pasi kryetari i ri i Kuvendit, Dimal Basha nga LV-ja, i ka hedhur në votim ndaras kandidatët për nënkryetarë të Kuvendit nga minoriteti joserb dhe ai serb. Kjo parti, që ka në Kuvend ka 9 nga 10 vendet e rezervuara për serbët, këmbënguli ta propozonte vetëm Sllavko Simiqin edhe pasi ai dështoi t'i merrte 61 votat e nevojshme pas tri raundeve të votimit. Kur ajo nuk pranoi të propozonte dikë tjetër për nënkryetar, Basha vendosi të hidhte short, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, për të nxjerrë një emër tjetër nga komuniteti serb. Përveç të gjithë deputetëve të Listës Serbe, për këtë post u propozua edhe Nenad Rashiq nga partia serbe Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë. As Rashiqi nuk i mori votat e nevojshme. Basha e shpalli njëanshëm të përfunduar konstituimin e Kuvendit pavarësisht prej moszgjidhjes së nënkryetarit të pestë.

Shkatërrohet rrjeti sirian: Paratë e drogës i shndërruan në ar, u transportua edhe në Kosovë

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Prokurorët italianë thanë se kanë shkatërruar një rrjet të udhëhequr nga sirianët. Ky rrjet akuzohet se pastronte paratë nga trafiku i drogës në Itali dhe Francë, duke i shndërruar paratë e gatshme në shufra ari. Ari më pas u transportua në shtete të ndryshme, përfshirë në Kosovë. Policia italiane arrestoi pesë persona në rajonet veriore të Piedmontit dhe Lombardisë duke sekuestruar 17 milionë euro, thanë prokurorët italianë përmes një deklarate. Hetimi u krye nga një ekip i

përbashkët që përfshinte policinë tatimore të Italisë dhe xhandarmërinë franceze në Marsejë dhe përpjekjet u koordinuan nga drejtoria kombëtare kundër mafias në Itali dhe zyra e prokurorit në Marsejë, së bashku me Eurojust dhe Europol. Gjatë më shumë se gjashtë muajve, të dyshuarit mblodhën më shumë se 17 milionë euro nga fitimet e drogës, kryesisht në Francë, dhe transportuan paratë në automjete drejt një zone pranë Piedmontit në Itali, që gjendet në kufi me Francën, thanë prokurorët. "Aty, në

bashkëpunim me tre biznese për shkrirjen e metaleve të çmuara në Piedmont dhe Lombardi, paratë u shndërruan në shufra dhe fleta ari në vlerën e njëjtë monetare", u tha në njoftim. Ari më pas u transportua në Kosovë, Maqedoni të Veriut, Turqi dhe Marok. "Është hera e parë që hetuesit kanë arritur ta rindërtojnë rrjedhjen e parave të drogës, të gjeneruara jashtë vendit, të cilat më pas janë shndërruar në ar - një aset që më lehtë transportohet", u tha në njoftim. Prokurorët thanë se kanë identifikuar një rrjet të gjerë të



shtetasve sirianë të përfshirë në këtë proces. Prokurorët italianë thanë se xhandarmëria franceze po ashtu ka kryer

arrestime të të dyshuarve të tjerë të përfshirë në mbledhjen e të ardhurave nga droga në Francë.

GËRXHALIU: ROLI I KOMUNAVE NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM EKONOMIK ËSHTË FUQIA QË SHPESH NËNVLERËSOHET

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 24 shtator - Ish-kryetari i Odës Ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka thënë se mungesa e dialogut dhe qasja politiko-partiake nga niveli qendror përball nivelit lokal apo komunave të Kosovës e ka denigruar imazhin dhe rëndësinë e komunave në zhvillim të përgjithshëm ekonomik-social.

Gërxhaliu ka thënë se roli i komunave në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik është fuqia që shpesh nënvlerësohet. Ai thotë se bllokohen projekte në interes të qytetarëve vetëm pse komuna udhëhiqet nga një parti tjetër politike dhe jo nga ajo e nivelit qendror. “Shumëkush mendon se vetëm qeveria qendrore mund ta ndryshojë ekonominë. Në fakt, pushteti lokal ka kompetenca reale që prekin përditshmërinë e qytetarit. Dhe pikërisht kjo e bën



të rëndësishme peshën e zgjedhjeve që po mbahen”, ka thënë ai.

Sipas Gërxhaliut, komunat kontrollojnë urbanizimin dhe tregun e ndërtimit. “Një komunë mund t’i ndalë ndërtimet spekulative, të vendosë rregull dhe të ndikojë drejtpërdrejt në

çmimet e banesave. Komunat krijojnë tregje lokale. Nëse fermeri ka hapësirë për ta shitur prodhimin, qytetari blen më lirë dhe ekonomia lokale merr frymë. Komunat ofrojnë shërbime publike - ujë, mbeturina, ndriçim, transport lokal. Cilësia e këtyre shërbimeve

përcakton standardin e jetesës dhe kostot për biznesin. Komunat mund të lidhin partneritete publike-private për infrastrukturë, parqe industriale, shërbime të reja. Komunat mund të jenë shembull transparence. Një kryetar që udhëheq me llogaridhënie e forcon besimin në shtet - dhe besimi është kapital i pazëvendësueshëm. Nëse qeveria qendrore flet për shifra, komuna flet për jetën e përditshme. Aty matet shteti”, ka theksuar Gërxhaliu, duke shtuar se Kosova nuk ka luksin të vazhdojë me dy iluzione. “Me nacionalizëm të zbrazët dhe me rritje ekonomike në letër. Një shtet nuk matet me raporte statistikash, por me dinjitetin e qytetarit të tij. Një ekonomi e vërtetë është ajo që i jep të riut arsye të qëndrojnë, që i jep punëtorit siguri, që i jep familjes banesë të përballueshme. Përvoja dëshmon se besimi i qytetarit dhe i biznesit nuk

fitohet me fjalë, por me institucione funksionale dhe me ekonomi reale. Kryetarët që do të zgjidhen në këto zgjedhje kanë përgjegjësi historike: të tregojnë se pushteti lokal mund të bëhet ura e zhvillimit, jo thjesht zyra e administrimit”, është shprehur ai.

Njohësi i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, ka thënë se Kosova ka nevojë për një kthesë. “Jo më iluzione, por vepra. Jo më ekonomi të shifrave, por ekonomi të qytetarëve. Rëndësia e zgjedhjeve lokale është e rëndësishme në shumë dimensione në interes të qytetarit dhe shtetit. Vota e gabuar dhe e pamërituar e vret ardhmërinë dhe mirëqenien e qytetarit. Të votohen ata që kanë ide dhe empati për qytetarin e jo të votohen ata që votën tuaj e shohin vetëm si mundësi për punësimin e tyre dhe një pagë të garantuar katërvjeçare! Vota nuk lypet, por meritohet”, ka deklaruar Gërxhaliu.

EKSPORTET E KOSOVËS NË VENDET E BE-së ARRITËN NË 23,4 MILIONË EURO

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin gusht 2025. Të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 7,7 % në muajin gusht 2025, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2024, gjegjësisht në vlerë prej 536,8 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 498,5 milionë eurosh në vitin 2024. Eksporti mbulon importin 12,4 %. Eksporti i mallrave në muajin gusht 2025 kishte vlerën 76,2 milionë euro, ndërsa importi 613,1 milionë euro, që është një rënie prej (-8,7 %) për eksport, si dhe një rritje prej 5,3 % për import, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Sipas të dhënave të grupeve

kryesore të eksportit: 18 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 13,8 % e përbëjnë produktet minerale; 13,8 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10,9 % e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 10,1 % e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 7,5 % e përbëjnë produktet bimore etj. Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore të importit: 15,5 % e përbëjnë produktet minerale; 13,1 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 12,1 % e përbëjnë mjetet e transportit; 11,4 % e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 8,7 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre etj. Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 23,4 milionë euro, ose rreth 30,7 % e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej -2,6 %. Partnerët



kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania 11,4 %, Holanda 2,4 %, Italia 2,1 %, etj. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 261,7 milionë euro, ose 42,7 % e importeve të përgjithshme, me një rritje prej

7,7 %. Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (14 %), Italia (4,2 %), Polonia (3,9 %) etj. Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 38,2 milionë euro, ose 50,1 % të eksporteve të

përgjithshme, me një rënie prej (-12,6 %). Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (22,4 %), Maqedonia e Veriut (13 %), Serbia (7,7 %), Mali i Zi (5,2 %). Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 77,9 milionë euro, ose 12,7 % të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 4,5 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia e Veriut (4,1 %), Shqipëria (3,6 %), Serbia (3 %). Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 14,7 milionë euro, ose 19,2 %. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (10,5 %) dhe Turqia (3,7 %). Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 273,5 milionë euro, ose 44,6 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (14,5 %) dhe Turqia (12,9 %).

Kosova dhe Turqia diskutojnë për rritjen e bashkëpunimit rreth kontrollit të cilësisë së ushqimit

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Drejtori ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Bekim Hoxha, priti në takim këshilltaren për tregti në Ambasadën e Turqisë në Prishtinë, Seda Ulukaya, me të cilën diskutoi për rritjen e bashkëpunimit midis Kosovës dhe Turqisë në sektorin që mbulon AUV.

Fokus i veçantë në takim ishte edhe kontrolli i cilësisë së ushqimit i cili hyn në Kosovë nga shtete të ndryshme si dhe kontrolli veterinar, fusha këto të cilat shërbejnë për rritjen e standardeve për të garantuar produkte të sigurta dhe cilësore për konsumatorët. Gjatë takimit të dyja palët u

pajtuan se thellimi i bashkëpunimit për shkëmbimin e përvojave të cilat ndikojnë në zhvillimin e kapaciteteve profesionale në fushën e kontrollit të ushqimit dhe shëndetit veterinar do të jetë prioritet për të ardhmen për agjencitë shtetërore të të dyja vendeve.



NOBEL PËR PAQEN? CILAT JANË 7 LUFTËRAT QË TRUMPI “U KA DHËNË FUND”

Pse Donald Trump beson se “e meriton Çmimin Nobel për Paqen” dhe pse thotë se “i ka dhënë fund shtatë luftërave”



Presidenti amerikan ka bërë “të qartë se nuk do të donte asgjë më shumë” sesa të fitonte këtë çmim prestigjioz, thonë ekspertët për Sky News, ndërsa sugjerimet e tij se është një kandidat i denjë fillojnë që nga mandati i tij i parë. Donald Trump ka përsëritur pretendimet se i ka dhënë fund disa luftërave në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, duke vijuar përpjekjet e tij për të marrë Çmimin Nobel për Paqen. Duke folur në Nju Jork, në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, ai tha se “të gjithë thonë se unë duhet ta marr Çmimin Nobel për Paqen”. Më herët, kur u takua me presidentin Volodymyr Zelenskyy dhe me liderë të tjerë europianë në Shtëpinë e Bardhë më 18 gusht, ai kishte deklaruar: “Unë i kam dhënë fund gjashtë luftërave” – duke u thënë gazetarëve të nesërmen se, në fakt, kishte zgjidhur shtatë.

Fushata e Trumpit për Nobel

2019

Në shkurt të vitit 2019, Trump pretendoi se kryeministri i atëhershëm japonez, Shinzo Abe, e kishte nominuar atë pas samitit të vitit 2018 me liderin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un, ku u diskutua programi bërthamor i

vendit. Duke folur nga Shtëpia e Bardhë, ai tha se z. Abe i kishte dhënë “kopjen më të bukur të një letre që ai ia kishte dërguar atyre që japin atë që quhet Çmimi Nobel”. Ai pretendoi se z. Abe i kishte thënë: “Unë të kam nominuar ty”, ndaj të cilit Trump ishte përgjigjur: “Faleminderit. Shumë njerëz të tjerë mendojnë po ashtu. Ndoshta nuk do ta marr kurrë. Por s’ka problem”. Presidenti vazhdoi duke iu referuar paraardhësit të tij, Barack Obama, që fitoi çmimin në vitin 2009. “E dhanë për Obamën. Ai as nuk e dinte përse e mori. Ishte aty vetëm për 15 sekonda dhe mori Çmimin Nobel,” tha ai. “Unë ndoshta nuk do ta marr kurrë.” Obama e fitoi çmimin vetëm nëntë muaj pas fillimit të presidencës së tij, për “përpjekje të jashtëzakonshme për të forcuar diplomacinë ndërkombëtare dhe bashkëpunimin mes popujve”. Në fjalimin e pranimit, ai pranoi polemikat që e shoqëruan, duke thënë: “Krahasuar me disa nga gjigantët e historisë që e kanë marrë këtë çmim – Schweitzer dhe King; Marshall dhe Mandela – arritjet e mia janë të vogla.” Në fund të vitit 2019, përpara një takimi me kryeministrin pakistanez Imran Khan, Trump u tha gazetarëve se ai “do të fitonte

një Çmim Nobel për shumë gjëra, nëse do ta jepnin në mënyrë të drejtë, gjë që nuk e bëjnë”.

2020

Në janar të vitit 2020, ai u ankua se duhej ta kishte fituar çmimin në vend të kryeministrit të Etiopisë, Abiy Ahmed Ali, i cili mbikëqyri firmosjen e marrëveshjes së paqes në konfliktin kufitar me Eritrenë. Duke iu referuar përfshirjes së tij në bisedimet e paqes, që u udhëhoqën kryesisht nga Arabia Saudite, Trump tha në një miting elektoral në Ohajo: “Do t’ju tregoj për Çmimin Nobel për Paqen, do t’ju tregoj për këtë. Unë bëra një marrëveshje, shpëtova një vend, dhe sapo dëgjova që kreu i atij vendi tani po merr Çmimin Nobel për Paqen për shpëtimin e vendit. Por e dini, kështu është. Për sa kohë që e dimë ne, kjo është ajo që ka rëndësi... Unë shmanga një luftë të madhe, kam shmangur disa prej tyre.”

2024

Në një tjetër miting, përpara fitores së tij të dytë elektorale në vitin 2024, ai u tha mbështetësve në Detroit: “Po të quhesha Obama, do ta kisha marrë Çmimin Nobel për Paqen për 10 sekonda.”

2025

Në shkurt të këtij viti, gjatë një takimi me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu në Shtëpinë e Bardhë, ai tha: “Ata kurrë nuk do të ma japin Çmimin Nobel për Paqen. E meritoj, por nuk do të ma japin kurrë.” Dhe më 18 gusht, gjatë një samiti me liderët ukrainas dhe europianë, ai tha: “Nëse shikoni gjashtë marrëveshjet që kam mbyllur këtë vit, të gjitha ishin në luftë.” Më 19 gusht, ai e korrigjoi veten, duke i thënë Fox News: “Ne i dhamë fund shtatë luftërave.” Edhe ekipi i tij ka shtuar thirrjet për t’i dhënë çmimin, me sekretaren e shtypit Karoline Leavitt që e ka përmendur disa herë në konferencat për shtyp në Shtëpinë e Bardhë, duke e përshkruar atë si “presidentin e paqes” dhe duke thënë se “është i vonuar tashmë.”

Si fitohet Çmimi Nobel për Paqen?

Kushdo mund të nominohet për këtë çmim, por faqja zyrtare paralajmëron se meqë nuk ka “verifikim të nominimeve”, “vetëm të jesh i nominuar nuk është një mbështetje apo nderim zyrtar dhe nuk mund të përdoret

për të nënkuptuar lidhje me Çmimin Nobel për Paqen apo institucionet e tij.”

Vetëm persona që plotësojnë kriteret të caktuara mund të bëjnë nominime, përfshirë krerë shtetesh, anëtarë qeverish, fitues të mëparshëm të Nobelit dhe profesorë universitetesh. Komiteti i Nobelit, një panel prej pesë ekspertësh të emëruar nga Stortingu norvegjez (trupi suprem legjislativ), përzgjedh një listë të shkurtër kandidatësh, të cilët më pas shqyrtohen nga konsulentë të jashtëm. Këta përfshijnë këshilltarë të përhershëm të komitetit, ekspertë norvegjezë dhe ndërkombëtarë në këtë fushë. Pasi ky informacion ndahet me komitetin, merret vendimi përfundimtar dhe fituesi shpallet çdo tetor. Në vitin 2025, kishte 338 kandidatë, përfshirë 244 individë dhe 94 organizata.

Cilat janë shtatë luftërat që Trump pretendon se i ka përfunduar?

Pas pretendimeve të tij se kishte “përfunduar shtatë luftëra” gjatë bisedimeve për Ukrainën në Uashington, Shtëpia e Bardhë publikoi listën e konflikteve për të cilat presidenti po fliste – gjashtë gjatë mandatit të tij të dytë dhe një në të parin.

Armenia dhe Azerbajxhani

Dy kombet kanë qenë të përfshirë në një konflikt pothuajse 40-vjeçar mbi statusin e diskutueshëm të Nagorno-Karabakhut. Së fundmi, përlshje të rënda shpërthyen në shtator 2023 kur Azerbajxhani pushtoi zonën, e cila ka qenë shtëpi e armenëve etnikë që nga koha para-sovjetike. Por më 8 gusht të këtij viti, një marrëveshje paqeje mes të dyja palëve u shpall në Shtëpinë e Bardhë, çka bëri që të dy liderët të nominojnë Trumpin për Çmimin Nobel. Sipas Dr. Theo Zenou, studiues në Henry Jackson Society, “ky është ndoshta pretendimi më i ligjshëm i Trump për paqe”. “Merita duhet dhënë aty ku i takon: ndërmjetësimi i një marrëveshjeje paqeje mes Armenisë dhe Azerbajxhanit është një arritje e vërtetë,” thotë ai.

Duke e përshkruar si një “simbol të rëndësishëm përparimi”, ai gjithashtu paralajmëron se kjo u bë kryesisht për shkak të “rënies së ndikimit të Rusisë në rajon” dhe se ende mbeten “pika të diskutueshme” mes të dyja palëve.

Tajlanda dhe Kamboxhia

Tensionet mbi tokën përgjatë kufirit 500 milje mes Tajlandës dhe Kamboxhias kanë vazhduar për më shumë se një shekull, duke sjellë shpërthime sporadike të luftimeve. Më 24 korrik, pasi zyrtarët tajlandezë pretenduan se trupat kamboxhiane hapën zjarr mbi një bazë ushtarake të tyre përgjatë kufirit, shpërtheu dhunë që la 35 të vdekur dhe zhvendosi qindra mijëra persona gjatë katër ditëve. Dy ditë më pas, Trump postoi në Truth Social: “Jam duke telefonuar Kryeministrin e Përkohshëm të Tajlandës, tani, për t’i kërkuar një armëpushim dhe FUNDIN e luftës që po shpërthen.”

Edhe pse ishte Malajzia ajo që priti bisedimet e paqes, Trump kërcënoi se do t’i ndalte negociatat mbi uljen e mundshme të tarifave amerikane ndaj importeve tajlandeze e kamboxhiane, nëse armëpushimi nuk do të respektohej. Më 7 gusht u nënshkrua një marrëveshje. “Stili i Trump është transaksional,” thotë Dr. Samir Puri nga Chatham House. “Ai përpiket të nxisë ekonomisht palët për të ndalur luftimet – por ka një diferencë të madhe midis ndalimit afatshkurtër të luftimeve dhe zgjidhjes së shkaqeve rrënjësore të konfliktit.”

Ruanda dhe Republika Demokratike e Kongos

Në fillim të vitit 2025, tensionet mes dy vendeve afrikane u

ringjallën kur rebelët M23 të mbështetur nga qeveria e Ruandës pushtuan një zonë të pasur me minerale në lindje të Republikës Demokratike të Kongos (DRC). Pas muajsh luftimesh, në qershor, ministrat e jashtëm të dy vendeve udhëtuan në Shtëpinë e Bardhë për të nënshkruar një marrëveshje duke u zotuar të respektojnë një armëpushim të mëparshëm nga viti 2024. Trumpi lëvdoi veten për krijimin e paqes në “njërën prej luftërave më të tmerrshme që ka parë ndonjëherë kushdo.” Megjithatë, grupi M23 nuk mori pjesë drejtpërdrejt në bisedime dhe deklaroi se nuk e konsideron marrëveshjen të detyrueshme. “Është e paprecedentë për një president amerikan të ndërhyjë në këtë konflikt,” vëren Dr. Puri, ndërsa Dr. Zenou e quan një “hap në drejtimin e duhur”, por thekson se mungesa e përfaqësimit të M23 do të thotë se lufta “me gjasë do të vazhdojë”.

Izraeli dhe Irani

Pas shpërthimit të luftës mes Iranit dhe Izraelit më 13 qershor, SHBA bombardoi tre nga objektet bërthamore të Iranit. Trump shpalli: “Zyrtarisht, Irani do të fillojë ARMËPUSHIMIN dhe, pas Orës së 12-të, Izraeli do të fillojë ARMËPUSHIMIN dhe, pas Orës së 24-të, FUNDI ZYRTAR I LUFTËS 12-DITORE do të përhendet nga Bota.” Kryeministri Netanyahu e lavdëroi SHBA-në, por Udhëheqësi Suprem i Iranit, Ajatollah Ali Khamenei, tha se sulmet nuk arritën asgjë dhe pretendoi se Irani doli fitues. Dr. Puri thekson se ky është i vetmi rast nga shtatë konfliktet ku Trumpi përdori forcë ushtarake, çka në vetvete është e lavdërueshme. Por, sipas tij, Trump thjesht “e shtyu konfliktin në një gjendje fjetjeje”, pa adresuar shkaqet rrënjësore. Dr. Zenou shton se nuk pati “marrëveshje paqeje” dhe se “të dyja palët mbeten në luftë”.

India dhe Pakistani

Dy vendet kanë luftuar mbi statusin e Kashmirit që nga ndarja e tyre në vitin 1947. Në maj, pas një sulmi në Kashmirin e kontrolluar nga India, tensionet u përshkallëzuan për katër ditë. Më 10 maj u shpall një armëpushim, që Trump e quajti rezultat i një “nate të gjatë bisedimesh të ndërmjetësuar nga SHBA”. Zyrtarët pakistanezë e nominuan atë për Nobel, por India mohoi fuqimisht çdo përfshirje të SHBA-së, duke këmbëngulur se bisedimet u zhvilluan “drejtpërdrejt mes Indisë dhe Pakistanit”. Dr. Puri e përshkruan këtë si pretendimin më “të dobët” të Trumpit: “Në asnjë mënyrë Trump nuk mund të thotë se e ka zgjidhur konfliktin Indi-Pakistan, që ka rrënjë të jashtëzakonshme strukturore.”

PRESIDENT TRUMP: THE PRESIDENT OF PEACE

President Trump ended 7 WARS in just 7 MONTHS:

Cambodia and Thailand
Kosovo and Serbia
DRC and Rwanda
Pakistan and India
Israel and Iran
Egypt and Ethiopia
Armenia and Azerbaijan



Egipti dhe Etiopia

Prej 12 vitesh, Egjipti dhe Etiopia janë përfshirë në një mosmarrëveshje mbi digën e madhe GERD në lumin Nil, e cila nisi operimin në vitin 2022. Etiopia e sheh digën si jetike, ndërsa Egjipti pretendon se ajo rrezikon furnizimin me ujë. Në fund të qershorit, bisedimet dështuan. Trump postoi: “Po të isha Egjipt, do të doja ujin e Nilit,” duke premtuar se SHBA do ta zgjidhte çështjen. Ai më pas pretendoi se SHBA kishte financuar pjesërisht digën – gjë që u mohua nga zyrtarët etiopianë, të cilët theksuan se ishte ndërtuar “pa asnjë ndihmë të huaj”.

Serbia dhe Kosova


Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia në vitin 2008, por Beogradi ende nuk e njeh. Në qershor të këtij viti, tensionet u përshkallëzuan. Trumpi shkroi online: “Serbia, Kosova do të shkonin drejt një lufte të madhe. Unë u thashë, nëse ndodh, nuk ka tregti me SHBA. Ata thanë, mirë, ndoshta nuk do të ndodhë.” Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se kishte

“informacion të besueshëm” se Trumpi kishte ndërhyrë për të parandaluar një përlshje, por nuk dha detaje. Shtëpia e Bardhë iu referua vetëm marrëveshjes së vitit 2020 në mandatin e parë të Trumpit, kur palët ranë dakord për normalizim ekonomik.

A mund ta fitojë realisht Trumpi, Nobelin?

Donald Trump është nominuar mbi 10 herë për Çmimin Nobel për Paqen – nga Netanyahu, Hun Manet (Kamboxhia), një politikan ukrainas, si dhe ligjvënës nga SHBA, Suedia dhe Norvegjia. Dr. Zenou paralajmëron se këto nominime janë më tepër diplomaci: “Trumpi e ka bërë shumë të qartë se nuk do asgjë më shumë sesa Nobelin. Liderët që e nominojnë po bëjnë qejfin.” Sipas tij, edhe pse nuk është në listën e “shtatë luftërave”, Marrëveshjet e Abrahamit (2020), që sollën njohjen e Izraelit nga disa shtete arabe pas gati 50 vitesh, mbeten arritja më e madhe diplomatike e Trumpit. Dr. Zenou i përshkruan ato si një “moment historik për Lindjen e Mesme”, veçanërisht sepse kanë mbijetuar pavarësisht konfliktit aktual mes Izraelit dhe Hamasit.

Megjithatë, mungesa e Arabisë Saudite në këtë listë është një nga “testet më të mëdha” për Trumpin. Edhe përpjekjet e tij për t’i dhënë fund luftës në Ukrainë mund të shihen si një rrugë drejt çmimit, thotë Dr. Puri: “Ukraina është ajo mbi të cilën do të gjykohej presidenca e tij. Është në pedestal, dhe Trumpi imagjnon se mund ta çojë deri në Oslo.” Por Puri rikujton diferencën mes “menaxhimit të konfliktit” dhe “zgjidhjes së konfliktit”: “Trump është më shumë në biznesin e menaxhimit, duke përdorur nxitje ose sanksione ekonomike për të bërë palët të flasin. Ai nuk po i zgjidh konfliktet.” Në fund, ai shton se megjithëse pretendimet e Trumpit janë shpesh të ekzagjeruara, fakti që ka ndërhyrë kryesisht pa përdorur forca të mëdha ushtarake (përveç Iranit) është diçka për t’u njohur. “Ka absurditet në pretendimet e Trumpit, por brenda absurditetit ndonjëherë ka kokrra të vërtete. Prandaj, të mos jemi tepër kritikë ndaj një presidenti amerikan, i cili, sado gabimisht, po përpiket të ndërhyjë në konflikte për t’i zgjidhur kryesisht pa ndërhyrje të drejtpërdrejtë ushtarake.” / Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sot zhvillohen ndeshjet e xhiros së gjashtë në Superligë

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Nuk ka pushim për elitën e futbollit të Kosovës, pasi Superliga do të vazhdojë me ndeshjet e xhiros së gjashtë që do të luhen sot (e enjte), ka njoftuar Federata

e Futbollit të Kosovës (FFK). Katër duele do të nisin në orën 15:00, ndërsa xhiroja do të mbyllet me duelin e orës 20:15 ndërmjet Prishtinës dhe Prishtinës së

Re që luhet në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet. Gjatë ditës do të ketë përballje interesante, ku pothuajse të gjitha mund të vlerësohen si ndeshje derbi. Në Suharekë, Ballkani e pret

kampionen në fuqi, Dritën, kurse në Klinë do të përballen Dukagjini me Llapin. Skuadra e Drenicës luan në udhëtim te Gjilani, ndërsa Malisheva e pret në shtëpi skuadrën e Ferizajt.

ANKUR B		
	15:00	
DUKAGJINI	15:00	LLAPI
	15:00	DRENICA
MALISHEVA	15:00	FERIZAJ

FESTA E 'GRASSROOTS'-IT VAZHDON NË PRIZREN, ADEMI: FUTBOLLI KA ROL KYÇ NË ZHVILLIMIN DHE EDUKIMIN E FËMIJËVE



PRIZREN, 24 SHTATOR - "Java e Grassroots" ka vazhduar rrugëtimin në Prizren, duke sjellë gjallëri, pasion dhe shumë buzëqeshje në fushë te fëmijët pjesëmarrës. Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka njoftuar se të rinjtë e këtij qyteti janë bashkuar nën të njëjtin qëllim:

të luajnë, të mësojnë dhe të ndajnë momente që shkojnë përtej lojës.

"Bashkë me kryetarin dhe stafin e LRF të Prizrenit, ish-futbollistët dhe trajnerët e këtij qyteti ishim pjesë e këtij aktiviteti për fëmijët. Grassroots po vazhdon të dëshmojë se përtej futbollit dhe talentit, ka rol kyç në

zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve mbi vlerat kolektive dhe unifikuese. FFK, si deri më tani, do të vazhdojë të organizojë aktivitete çdo ditë gjatë tërë vitit në tërë Kosovën, ashtu siç e ka shtrirjen programi Grassroots. Java e Grassroots do të vazhdojë edhe në ditët në vijim në komuna të tjera", ka njoftuar Ademi.

LIRIA NDAHET ME KLODIAN DURON

Klubi i futbollit Liria është ndarë përfundimisht me trajnerin Klodian Duro.


Prizrenasit nuk e kanë nisur mirë sezonin e ri në drejtimin e trajnerit shqiptar duke ngecur prapa në garën për t'u rikthyer në Superligë, prandaj edhe kanë vendosur t'i ndajnë rrugët me ish-përfaqësuesin shqiptar të cilin e kanë falënderuar për punën dhe bashkëpunimin. "Klubi i Futbollit FC Liria njofton se

trajneri i ekipit të parë, Klodian Duro, është larguar nga drejtimi i skuadrës për arsye personale. FC Liria shpreh mirënjohjen më të thellë për përkushtimin, punën e palodhur, kontributin dhe profesionalizmin që trajneri Duro ka treguar gjatë gjithë periudhës së tij në klub. I urojmë suksese të shumta në të

ardhmen si në aspektin personal, po ashtu edhe në karrierën profesionale. Në ditët në vijim klubi do të njoftojë mbi zgjedhjen e trajnerit të ri dhe hapat e mëtejshëm në drejtimin e skuadrës", ka njoftuar Liria. Liria aktualisht është e 10 në Ligën e Parë me 12 pikë, 8 më pak se lideri, Vëllaznimi.



ALBION RRAHMANIT I RRRITET VLERA NË TREG



PRISHTINË, 24 SHTATOR - Sulmuesi i Kombëtares së Kosovës, Albion Rrahmani, është lojtari i shtrenjtë te Sparta e Pragës, ndërsa i dyti me vlerën më të lartë të Superligës e Çekisë. Në përditësimin e vlerës së tregut të elitës së futbollit çek në faqen "Transfermarkt", Sparta

është konfirmuar si skuadra më e shtrenjtë. Gjashtë prej dhjetë lojtarëve më vlerën më të lartë janë pjesë e Spartës, kurse më i shtrenjti i këtij ekipi është pikërisht Rrahmani. Forma e tij fantastike në fillim të këtij sezoni ka bërë që Rrahmani të ketë rritje të vlerës në treg për 60 për qind, ku

kartoni i tij tani vlerësohet 8 milionë euro nga 3 milionë sa ishte më parë. Në 15 ndeshjet e para të këtij sezoni në të gjitha garat, Rrahmani ka shënuar 8 gola dhe ka bërë një asistim. Në kampionat, Rrahmani ka pesë gola të realizuar dhe është i dyti në listën e golashënuesve më të mirë.

Kupa e Botës pritët të zgjerohet në vitin 2030

PARIS, 24 SHTATOR - Në nivel të ekipeve kombëtare, Kupa e Botës mund të pësojë ndryshim sa i përket numrit të skuadrave pjesëmarrëse. Sipas lajmit të "Athletic", FIFA është duke e shqyrtuar mundësinë e rritjes së numrit të kombëtareve që do të marrin pjesë në turneun e vitit 2030, i cili do të organizohet bashkërisht nga

Maroku, Spanja dhe Portugalia. Është thënë se presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, është takuar me zyrtarë të CONMEBOL-it, organi përgjegjës për futbollin e Amerikës së Jugut. Për ta ndryshuar numrin e ekipeve pjesëmarrëse, çështja duhet të diskutohet dhe të miratohet nga Këshilli i FIFA-s. Kupa e Botës, e cila për herë të

parë është organizuar në vitin 1930, në vitin 2030 do ta shënojë 100-vjetorin e saj. Për këtë arsye, përveç vendeve organizatore, do të zhvillohet nga një ndeshje edhe në Paraguaj, Uruguaj dhe Argentinë. Pas ndeshjeve të para, takimet e mbetura të Kupës së Botës 2030 do të ndahen mes

vendeve pritëse: Marokut, Portugalisë dhe Spanjës. Numri i ekipeve pjesëmarrëse në Kupën e Botës ishte rritur nga 16 në 24 në vitin 1982, dhe më pas në 32 në vitin 1998. Ndërsa në Kupën e Botës 2026, që do të organizohet nga Shtetet e Bashkuara, Kanadaja dhe Meksika, do të garojnë 48 ekipe kombëtare.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Micom-M Plus” SH.P.K. me seli në Leposaviç, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810699655 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Micom-M Plus” D.O.O. Leposavic donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810699655 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Micom-M Plus” L.L.C. with headquarters Leposaviç, has come to the decision to quit its business: 810699655 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly requested to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Sanije Shosholli shpall të pavlefshme vërtetimin e lëshuar nga Qendra e Aftësimit Profesional – Mitrovicë, Profili – TEKSTIL,. Numri i vërtetimit: 476/2005.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë "Htsni Zajmi".

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. "Gjon Nikolle Kazazi" Teknologji Informative Giakove.

- NNSH "Meridian", shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.


- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr vit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Ndërmarrja Publike Lokale
NPL Eko Natyra Sh.A Skenderaj

KOMUNA SKENDERAJ OPSTINA SKENDERAJ	
Ndërmarrja Publike Lokale NPL Eko Natyra Sh.A Skenderaj	
Data Pranimi Detyrat: 24/09/2025	
Titulli: Përgjegjësi i punës	
Nyrtia Org. Njësia	Nr. Pril. Nr. Pjesë
001	001 278 25 004

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenin 20 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 056/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L “Eko Natyra” Sh. A e miratuar me datë 16.06.2025 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L “Eko Natyra” Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 277/25 të datës 23.09.2025 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L “Eko Natyra” Sh. A, me datë 24.09.2025 shpall:

KONKURS PUBLIK

- I. Titulli: Mirëmbajtës i Hapësirave Publike
- Numri i ekzekutuesve: 1
- Orët e punës: 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
- Përgatitja profesionale: Shkolla fillore
- Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune
- I raporton: Udhëheqësit të Njësive të Mirëmbajtjes së Hapësirave Publike
- Koeficienti i pagës: (533) Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kujdeset për ruajtjen, pastrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve të qytetit.
- Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen për rrethojnë e parqeve.
- Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e inventarit për rekreacion dhe pushim në parqe.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e stazave dhe gjelbërimit në parqe.
- Mbjellë, kultivon lule dhe bari, si dhe kositë dhe rregullon ato, duke përfshirë ujitjen dhe freskimin.
- Kultivon, mirëmban dhe krasitë drunjtë në pronësi publike.
- Mban higjienën dhe pastrimin e parqeve dhe shesheve.
- Hapjen e varrezave.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, martirëve, lapidarëve, përmendoreve, pllakave përkujtimore, të cilat menaxhohen nga komuna.
- Fshirjen e oxhaqeve në objektet publike dhe private, në bazë të tarifave të përcaktuara paraprakisht.
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Njësive të Mirëmbajtjes së Hapësirave Publike.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L “Eko Natyra” Sh. A - Skenderaj. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (E skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (Certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (Certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative), duke i bashkëngjitur CV);
- Kopjen e letërnjoftimit (E skanuar);

II. Titulli: Elektricit

- Numri i ekzekutuesve: 1
- Orët e punës: 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
- Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme
- Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit në fushën përkatëse
- I raporton: Mbikqyrësit të Punëve Operative në Teren.
- Koeficienti i pagës: (550) Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Është përgjegjës për punët që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e ndriçimit publik.
- Zbaton detyrat dhe aktivitetet operative të përcaktuara nga udhëheqësi i tij.
- Është përgjegjës për mirëmbajtjen e ndriçimit, si dhe punët tjera të elektrikes në ndërmarrje.
- Mban përgjegjësi për materialin e shpenzuar, si dhe shpenzimet e materialit i shënon në dëshmitë përkatëse sipas dokumentacionit të N.P.L.
- Për punën e vet i përgjigjet Mbikqyrësit të Punëve Operative në Teren.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L “Eko Natyra” Sh. A - Skenderaj. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);

- Jetëpërshkrimi;
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

Periodha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të tij. Shpallja është e hapur nga data 24.09.2025 deri me datë 08.10.2025 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 15.10.2025.
- Afati për ankesë nga data 16.10.2025 deri me datë 18.10.2025.
- Periodha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 28.10.2025.
- Afati për ankesë nga data 29.10.2025 deri me datë 03.11.2025 (meqenëse datat 01.11.2025 (e shtunë) dhe 02.11.2025 (e diel) janë ditë vikendi, afati për paraqitjen

e ankesës shtyhet dhe përfundon më 03.11.2025 (e hënë), në përputhje me dispozitat ligjore për afatet që përkohjnë me ditë pushimi.

- Periodha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 10.11.2025.
- Afati për ankesë nga data 11.11.2025 deri me datë 13.11.2025.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 25.11.2025.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L “Eko Natyra” Sh. A në qytetin e Skenderajt, rr. “Ali Gashi” çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do t'u asistoj dhe t'u jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: eko.natyra2021@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Përfundim

N.P.L “Eko Natyra” Sh. A në Skënderaj ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L